

# KONTRATE

**KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

**N.T.N "Erza"-Dragash** (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

**Vizitë studimore e delegatëve dhe shërbimit të Kuvendit të Komunës së Dragashit në Maqedoni dhe Shqipëri: (Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Ohër, Strugë, Pogradec....) dhe anasjelltas** me numër Identifikues 621-18-6326-2-3-6, dhe nr. Te mbrendshem te prokurimit 621-2018-097-236.

## **Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Vizitë studimore e delegatëve dhe shërbimit të Kuvendit të Komunës së Dragashit në Maqedoni dhe Shqipëri: (Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Ohër, Strugë, Pogradec....) dhe anasjelltas.**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **05.10.2018** dhe përfundon me **08.10.2018**.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 2 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i [kryerjes së shërbimeve] do të jetë **(Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Ohër, Strugë, Pogradec....) dhe anasjelltas. Akomodimi i delegatëve dhe shërbimit të Kuvendit në hotel (All inclusive), perzgjedhje sipas dëshires (tri racione ditore), akomodimi në dhomat e hotelit duhet të jete maximum 2(dy) persona, numri i personave pjesmarres në vizite është 30 (tridhjet) persona, për kater (4) dite dhe tri (3) nete.**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

1.6 Menagjer i kontratës (shërbimit) do të jete: **Betim Merdiu**

## **Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
Komuna e Dragashit  
Opština Dragash  
03 Nr. Br. 400-22102  
03.10.2018  
Dragash - Dragash



### **Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **5,339.00 € €**; (pese mij e treqind e tridhjetë e nente Euro).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

### **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë shërbimit, me një raport të menagjerit të projektit dhe komisionit për pranim të shërbimeve.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

### **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

### **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i [shërbimeve] duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

### **Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni do të mbetet valid deri në përfundim të tërë shërbimit.

### **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera



të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

#### **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshhtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

#### **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

#### **Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.


#### **Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

#### **Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **Gjykata themelore në Prizren, dega në Dragash** në pajtim me ligjin e Kosovës.



**Neni 14**

**Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqipe] për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

**Për Operatorin Ekonomik**

**Për Autoritetin Kontraktues**

<b>Emri:</b>	<b>N.T.N. "Erza"-Dragash</b>	<b>Emri:</b>	<b>Nuro Ismaili</b> 007
<b>Pozita:</b>	<i>Drejtor</i>	<b>Pozita:</b>	<b>Zyrtar</b> pergjegjes i <b>prokurimit.</b>
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	<b>03.10.2018</b>	<b>Data:</b>	<b>03.10.2018</b>
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

Numri i Prokurimit: 621-18-6326-2-3-6 – Titulli i Vizitë studimore e delegatëve dhe shërbimit të Kuvendit të Komunës së Dragashit në Maqedoni dhe Shqipëri: (Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Ohër, Strugë, Pogradec....) dhe anasjelltas

**PJESA C: FORMULARI I PARAOJTJES SË KUOTIMIT TË ÇMIMIT**

**Seksioni I. Formulari i KUOTIMIT TË ÇMIMIT**

Për: KUVENDI I KOMUNES DRAGASHI (më tej "Autoriteti Kontraktues")

Titulli i Kontratës: Vizitë studimore e delegatëve dhe shërbimit të Kuvendit të Komunës së Dragashit në Maqedoni dhe Shqipëri: (Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Ohër, Strugë, Pogradec....) dhe anasjelltas

Në përgjigje të letrës suaj të ftesës për tender për kontratën e mësipërme, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Ne kemi shqyrtuar dhe pranuar përbajtjen e plotë të dosjes së tenderit Nr 621-18-6326-2-3-6. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësinë e tyre, pa rezervim ose kufizim.

2. Çmimi i përgjithshëm i kuotimit është:

Çmimi i përgjithshëm i kuotimit në shifra: 5339 €

Dhe me shkrim pes mij e treqind e tritëshe e nënshkruar Euro



3. Ky kuotim është i vlefshëm për një periudhë prej [shëno numrin e ditëve – 30 ditë] nga data përfundimtare për dorëzimin e kuotimit të çmimeve.

4. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Ne gjithashtu plotësisht të njohim dhe pranojmë se ndonjë informacion të pasaktë ose të paplotë të dhënë me qëllim në këtë aplikacion mund të rezultojë në përjashtimin tonë nga kjo dhe kontrata të tjera të financuara nga BKK.

5. Çmimi i përgjithshëm i kuotuar është fiks dhe nuk i nënshtrohet ndonjë ndryshimi gjatë kontratës (duke përjashtuar çmimet e këtyre artikujve që janë subjekt i rregullimeve të çmimeve në bazë të shkëmbimit të aksioneve përkatëse). Çmimi i përgjithshëm i kuotuar specifikohet dhe është i bashkangjitur në Specifikimet e Çmimit.

**DORËZUAR NGA:**

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	NTN"ERZA"
ADRESA E PLOTË	BLAQ - DRAGASH
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	SELAMI NEBIJA

Numri i Prokurimit: 621-18-6326-2-3-6 – Titulli Vizitë studimore e delegatëve dhe shërbimit të Kuvendit të Komunës së Dragashit në Maqedoni dhe Shqipëri: (Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Ohër, Strugë, Pogradec....) dhe anasjelltas

POZITA	MENAXHER
NENSHKRIMI	
DATA	04.09.2018
VULA	

## Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Nr. i Artikullit.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njesi DDP <sup>6</sup> - €	Çmimi total €	Koha e dërgesës
1.					5339 €	
2.						
etj						
<b>Totali i Përgjithshëm:</b>					5339 €	

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISE	NTN"ERZA"
ADRESA E PLOTE	BLAQ - DRAGASH
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	SELAMI NEBIJA
POZITA	MENAXHER
NENSHKRIMI	
DATA	04.09.2018
VULA	

<sup>6</sup> Detyrimi i Dorëzimit është Paguar - Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare.

**Vizitë studimore e delegatëve dhe shërbimit të Kuvendit të Komunës së Dragashit në Maqedoni dhe Shqipëri: (Tetovë,Gostivar,Kërçovë,Ohër,Strugë,Pogradec....) dhe anasjelltas**

Nr	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali me TVSH
1	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Transporti I delegatëve nga Dragashi në: (Maqedoni dhe Shqipëri (Tetovë,Gostivar,Kërçovë,Ohër,Strugë,Pogradec....) dhe anasjelltas)</li> <li>• Akomodimi I delegatëve dhe shërbimit të Kuvendit në hotel (All inclusive) përzgjedhje sipas dëshirës (tri racione ditore).</li> <li>• Akomodimi në dhomat e hotelit duhet të jetë maximum 2 (dy) persona.</li> <li>• Numri I personave pjesëmarrës në vizit është (tridhjetë persona)</li> <li>•(Katër ditë,tri netë)</li> </ul>	ditë	4	1334,75	5339,00

**Totali: 5339,00€**

**Vërejtje:**

- Akomodimi I delegatëve duhet të bëhet në qytetin e Strugës.
- Operatorët ekonomik janë të obliguar se varësisht prej kërkesave të delegatëve,ushqimi duhet tu servohet edhe jashtë hotelit varësisht se ku gjenden ata në vizitë studimore në qytetet e lartëcekura .
- Operatori ekonomik përjashtohet nga pagesa nëse vizitohen monumente të ndryshme ku hyrja është me pages.
- Pagesa Operatorit ekonomik do ti bëhet pas kthimit nga vizita studimore në Maqedoni.

